



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/ 02-10165/25
Kaçanik, 30.05.2025

Në mbështetje të nenit 12. 2 (d), 17 (f) dhe (p) të Ligjit Nr. 03 L-040 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 53 pika 3 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, duke vendosur sipas Kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës 1359-2/25 të datës 30.04.2025, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 maj 2025, merr këtë:

VENDIM

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01 NR.104/02-3943/25 TË DATËS 27.02.2025 PËR
MIRATIMIN E PLANIT NDËRKOMUNAL PËR RAJONIN E GJILANIT DHE
FERIZAJT**

1. Me këtë Vendim SHFUQIZOHET Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 NR.104/02-3943/25 i datës 27.02.2025 - për miratimin e Planit ndër komunal për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, për shkak të disa konstatimeve si në Kërkesën nr. 1359-2 të datës 30.04.2025 të Ministrisë Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit, pasi veprimet e nevojshme marrin kohë deri në përmbushje nga komuna.
2. Plani ndër komunal për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, do të trajtohet në Kuvendin e Komunës, me iniciimin e procedurës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, përkatësisht Kryetarit të Komunës, pas marrjes së veprimeve të nevojshme të përcaktuara në Kërkesën nr. 1359-2 të datës 30.04.2025 nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do përkujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	18.06.25	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	104/02-13921
		Shtojcë	1



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Do. sh. org. Org. / Unit	DL
No. f. origj. No. of original	02
Do. sh. origj. No. of original	4512-2/25
Data Date	17.06.25
PRISHTINË / A	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, UD. Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. VL 118/25 Date: 11.06.2025
1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	Shendrita Latifi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të
2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr. 104/02-10165/25 për shfuqizimin e Vendimit 01 Nr. 104/02-3943/25 të datës 27.02.2025 për miratimin e Planit Ndërkomunal për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.05.2025

I nderuar kryetar Ilazi,
I nderuar kryesues Murseli

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 09.06.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01 Nr. 104/02-10165/25 për shfuqizimin e Vendimit 01 Nr. 104/02-3943/25 të datës 27.02.2025 për miratimin e Planit Ndërkomunal për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.05.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave:

KONFIRMON

Vendimin 01 Nr. 104/02-10165/25 për shfuqizimin e Vendimit 01 Nr. 104/02-3943/25 të datës 27.02.2025 për miratimin e Planit Ndërkomunal për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.05.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të Vendimit të lartcekur konstatoi se:

Kuvendi Komunal i Kaçanikut ka vepruar në përputhje me vlerësimin e ligjshmërisë Nr. Prot. 1359-2/25, datë 30.04.2025, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Në përputhje me këtë vlerësim, shfuqizohet Vendimi 01 Nr.104/02-3943/25 për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Gjilanit dhe Ferizajt për arsyet e theksuara në atë vlerësim.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 104/02-3943/25
Kaçanik, 27.02.2025

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, Komunës, Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 dhe Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Ndërkomunal, të nenit 6.2 lidhur me nenin 35 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit 01Nr. 104/02-3943/25 të Kryetarit të Komunës, të arsyetuar nga drejtoria e Shërbimeve publike dhe Emergjencave, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 27 shkurt 2025, mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe Inspektorati komunal.
3. Ky Vendim Hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Vendimi 01Nr. 07-104/01-7011/23; Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt; Iniciativa për bashkëpunim ndërmjet komunave përkatëse në fushën e sektorit të menaxhimit të integruar të mbeturinave; Vendimi i Kryetarit 01Nr. 1Nr.104/02-23165/22 për formimin e grupit teknik; Memorandumi i mirëkuptimit për iniciimin e menaxhimit të integruar të mbeturinave në regjionin e Gjilanit dhe Ferizajt; VSM e Planeve Ndërkomunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave për komnatat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shterpcë, Kosovë.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (përmes saj njoftohen organet tjera relevante), Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli